



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 03 Mars 2021

Nr: 112

VENDIM

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONERIT SHTETËROR TË
ZGJEDHJEVE NR.29, DATË 14.12.2020, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË
SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL
2021”**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “k”, shkronja “n”, dhe 2, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenin 144, paragrafi 1, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pas miratimit të ligjit nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, me vendimin nr. 29, datë 14 dhjetor 2020, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, miratoi strukturën buxhetore për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021.

Fondi i vënë në dispozicion për zërin paga dhe shpërblime pas miratimit të vendimit më nr.07 datë 02 mars 2021, të Komisionit Rregullator “Për caktimin e personelit të kualifikuar për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit në qendrat e votimit” është i pamjaftueshëm për mbulimin e nevojave të shtuara. Referuar vendimit të sipërcituar pagesa e operatorëve është në vlerën 49,500,000 (dyzet e nëntë milion e pesëqind mijë) lek.

Në zërin e parashikuar për mallra është e nevojshme të shtohet blerja e materialeve mbrojtëse, me qëllim reduktimin e transmetimit dhe parandalimit të përhapjes së infeksionit COVID-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Komisionit Qendror i Zgjedhjeve, të veprimtarisë së qendrave të votimit, si dhe gjatë ushtrimit të veprimtarisë në Vendet e Numërimit të Votave.



Për shkak të ndryshime të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i cili prek edhe anën organizative të procesit zgjedhor, është e nevojshme të shtohen në buxhet shërbime dhe mallra të cilat ishin të paparashikuara më parë.

Referuar VKM, nr.74, datë 05.02.2021 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2021, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për organizimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 prill 2021” si dhe kërkesave të reja për shërbime të cilat ishte e pamundur për tu parashikuar më parë, lind e nevojshme rishikimi i strukturën buxhetore për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “k”, shkronja “n”, dhe 2, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenin 144, paragrafi 1, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

VENDOS:

1. Ndryshimin e strukturës së shpenzimeve buxhetore për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill, sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



PASQYRA PERMBLEDHESE E RISHIKIMIT TË STRUKTURES SE SHPENZIMEVE BUXHETORE PER ZGJEDHJET PER KUVENDIN 2021

Nr.		Miratuar me vendimin nr.29, date 14.12.2020	Buxheti I rishikuar
		ishte	behet
I	PAGAT	341,679,346	300,000,000
1	Pagat personelit te perkohshem ne KQZ	68,895,755	69,000,000
2	Sigurime shoqerore dhe shendetesore per personelin e perkohshem	11,505,591	11,000,000
3	Shperblimi i anetareve te KZAZ-ve, KQV-ve, GNV-ve, trajnuesve te KZAZ,KQV,GNV	261,278,000	220,000,000
II	MALLRA	189,425,025	228,590,925
1	Materiale (prodhime specifike), import	119,193,000	113,800,000
2	Materiale (prodhime specifike), brenda vendit	10,941,100	11,000,000
3	Materiale te tjera (karburant)	2,600,000	2,600,000
4	Materiale (shtypshkrime)	45,697,811	45,697,811
5	Materiale (kancelari)	10,993,114	10,993,114
6	Elemente mbajtes inox per VNV-te (shiriti ndares i perfshire)		29,500,000
7	Materiale anti covid-19		15,000,000
III	SHERBIME	777,531,589	402,409,075
1	Sherbime transporti	21,300,000	21,300,000
2	Sherbime udhetim e dieta	8,539,500	8,539,500
3	Sherbime per njoftime	1,730,000	1,730,000
4	Sherbime qeramarrje	28,764,970	28,764,970
5	Sherbime te ndryshme	49,192,756	49,192,756
6	Sherbime per mediat elektronike dhe te shkruara (edukim, informim, sensibilizim)	124,129,635	87,000,000
7	Pagesa e personelit të kualifikuar për përdorimin e PEI		49,500,000
8	Sherbime per regjistrimin dhe transmetimin e numerimit te votave	150,200,352	150,200,352
9	Sherbime te ndryshme doganore		6,181,497
IV	Investime		526,000,000
1	Kamera per sistemin video-monitorimin ne qendrat e votimit	393,674,376	394,000,000
2	Projekti pilot i votim numerimit elektronik ne KZAZ nr.40		132,000,000
	TOTALI	1,308,635,960.13	1,457,000,000



Data: 03 Mars 2021
Nr. 112

Për një ndryshim në vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.29, datë 14.12.2020 “Për miratimin e strukturës së shpenzimeve buxhetore për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”